



PROGRAMI PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE ME QËLLIM IDENTIFIKIMIN E NEVOJAVE PËR PËRMIRËSIM

KLASA VII

Gjuhë shqipe
Matematikë
Gjuhë e huaj

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE.....	2
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE	4
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E MATEMATIKËS.....	10
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	15

HYRJE

Institucionet arsimore në të gjithë botën janë duke u përballur me sfidat që solli pandemia COVID-19. I njëjti realitet është edhe në shkollat tona. Për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të siguruar shëndetin e mësuesve dhe të nxënësve, shkollat e realizojnë procesin mësimor mbi bazën e orientimeve të dhëna në Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Në këtë udhëzues parashikohen tre skenarë për zhvillimin e procesit mësimor:

- 📖 mësim në shkollë;
- 📖 mësim i kombinuar (në shtëpi dhe në shkollë);
- 📖 mësim në kushtet e shtëpisë (online).

Këta skenarë janë zbatuar nga shkollat në varësi të infrastrukturës, të numrit të nxënësve dhe të situatës epidemiologjike. Mësimi në distancë ose i kombinuar ka bërë të mundur që pjesa më e madhe e nxënësve të vijojë normalisht me ndërtimin e njohurive dhe të aftësive lëndore, megjithatë ka pasur nxënës që për arsye të ndryshme (kanë kaluar COVID-19, nuk kanë pasur gjithmonë akses në internet, nuk ka qenë gjithmonë e mundur ndihma e prindërve, kanë nevojë për mbështetjen e mësuesit etj.), kanë pasur vështirësi në këtë proces.

Për të identifikuar vështirësitë dhe nevojat e nxënësve do të realizohen disa testime vjetore në lëndët kryesore. Këto teste janë *diagnostikuese*, nuk vlerësohen me notë dhe kanë për qëllim vetëm identifikimin e nevojave të nxënësve në lidhje me njohuritë dhe aftësitë kryesore të programeve mësimore.

Në klasën e shtatë do të zhvillohen dy teste:

- Gjuhë shqipe dhe Matematikë (ky test do të jetë i përbashkët për të dyja lëndët)
- Gjuhë e huaj

Për të orientuar hartuesit e testeve, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave është hartuar programi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në lëndët “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj”. Këto lëndë zhvillojnë te nxënësit kompetencat më të rëndësishme, të cilat janë jo vetëm kusht për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por edhe për suksesin në jetë dhe në tregun e punës. Hartimi i këtij programi është mbështetur në programet e gjuhës shqipe, të matematikës dhe të gjuhës së huaj për klasën e shtatë dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

Programi ka tri pjesë:

1. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e gjuhës shqipe
2. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e matematikës
3. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e gjuhës së huaj

Përdoruesit e programit janë:

- specialistët e vlerësimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të cilët do të bazohen në këtë program për hartimin e testeve;
- mësuesit, të cilët do t'i përdorin rezultatet e testit për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe për planifikimin e punës në lidhje me përmirësimin e arritjeve;
- drejtuesit e shkollave, të cilët do të koordinojnë dhe do të monitorojnë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe përmirësimin e tyre.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
	<p data-bbox="797 562 1312 598">Të lexuarit për të kuptuar tekstin ¹</p> <p data-bbox="797 642 919 674">Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li data-bbox="797 724 1421 800">- përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me shembuj dhe detaje nga teksti; <li data-bbox="797 808 1421 884">- u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit; <li data-bbox="797 892 1421 1014">- lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme; <li data-bbox="797 1022 1421 1098">- krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj.; <li data-bbox="797 1106 1421 1312">- gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit (<i>A mendoni se ky veprim zbulon diçka nga karakteri i personazhit? Ku e mbështetni mendimin tuaj? etj.</i>); <li data-bbox="797 1320 1421 1526">- interpreton idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar në tekst (<i>Pse autori nuk e jep në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë ide? Si e kuptuat ju? etj.</i>); <li data-bbox="797 1535 1333 1570">- dallon tekstet letrare dhe jo letrare; <li data-bbox="797 1579 1421 1698">- dallon elemente të formës dhe të përmbajtjes së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre.
Tekste letrare	Të lexuarit e teksteve letrare

¹ Këto rezultate janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe jo letrare.

- Poezi, tregime, legjenda, përralla, romane, tekste të thjeshta dramatike.
- Tema, ideja kryesore, subjekti i një teksti letrar.
- Tiparet kryesore të një teksti poetik, teksti në prozë dhe teksti dramatik (p.sh., tiparet e përrallave, legjendave apo të tregimeve).
- Llojet kryesore të strofave dhe të rimave.
- Hiperbola, aliteracioni.

Nxënësi:

- lexon tekste të ndryshme letrare poetike, në prozë dhe dramatike;
- shpreh përshtypjet dhe ndjesitë e tij për tekstet që lexon;
- tregon brendinë ose përmbajtjen e tekstit;
- bën pyetje të ndryshme rreth tekstit;
- u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij ose me shembuj nga teksti;
- rendit ngjarjet e një teksti;
- përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet;
- përshkruan pamjen e jashtme, tiparet, sjelljen e personazheve (duke u bazuar në tekst);
- analizon marrëdhëniet mes personazheve, vlerëson sjelljet e tyre, si dhe i krahason me veten ose njerëzit që njeh;
- gjen në tekst idetë kryesore dhe formulon temën;
- jep dhe argumenton këndvështrimet e tij rreth temës, ideve, personazheve etj.;
- kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe i përdor ato;
- dallon hiperbolën dhe aliteracionin, si dhe tregon efektin që krijojnë ata;
- shpjegon kuptimin e një teksti poetik, duke u bazuar në ndjenjat dhe përvojën e tij;
- dallon rimën dhe strofën (llojet kryesore) në një tekst poetik;
- dallon disa karakteristika të disa teksteve në prozë, si p.sh.: fabulave (personazhet, personifikimi, alegoria, morali i fabulës etj.); përrallave (elementet fantastike, formulat e hyrjes dhe mbylljes, personazhet joreale, formulat e magjisë, fundi i lumtur, hiperbolat etj.);

	<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon disa elemente të strukturës së një teksti dramatik si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë.
Tekste jo letrare <ul style="list-style-type: none"> - Autobiografi, biografi, rregullore, ese. - Tiparet e përgjithshme të një autobiografie, biografie, kronike, rregulloreje, eseje. - Organizimi i tekstit (rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.). - Fakti dhe opinionet në një tekst. 	Të lexuarit e teksteve jo letrare <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste si: autobiografi, biografi (të një shkrimtari, sportisti, shkencëtari), rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, ese etj.; - dallon dhe përdor njohuritë rreth karakteristikave të përbashkëta të teksteve si: tema, paragrafi, fjalitë përmblyëse, fjalori etj.; - dallon dhe përdor njohuritë rreth mënyrës së organizimit të tekstit (rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.); - pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore (nga tekstet që lexon) dhe i përdor ato; - dallon shkakun dhe pasojën në një tekst; - dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst; - dallon faktet dhe opinionet në një tekst; - dallon në një tekst përdorimin e argumenteve pro dhe kundër për një çështje të caktuar; - shpjegon funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve, me të cilat shoqërohen tekstet.
Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	
	Procesi i të shkruarit <p>Nxënësi:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon qëllimin e tij kur shkruan një tekst; - zgjedh formën e duhur të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit që ka; - mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose me shembuj të ndryshëm; - respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje); - përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore; - bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen dhe qartësinë e tekstit, si dhe drejtshkrimin.
<p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrime tregimesh duke iu përmbajtur elementeve si: fabul, personazh, dialog, mjedis, kohë. - Përshkrime personazhesh. - Kthimi i një teksti poetik në prozë. - Mbresa nga udhëtimet. 	<p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve si: personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë; - kthen një tekst poetik në prozë; - përshkruan personazhe të ndryshme; - përshkruan mbresat e tij nga udhëtime të ndryshme.
<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzime p.sh., si funksionon një lojë në kompjuter. - Intervistë e shkurtër drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për nxënësit nga fusha e artit, sportit, kinematografisë. Ese. 	<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan udhëzime të shkurtra; - shkruan një intervistë drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për të nga fusha e artit, sportit, kinematografisë; - shkruan ese.
<p align="center">Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës</p>	

Sintaksë

- Kallëzuesi i thjeshtë dhe kallëzuesi i përbërë.
- Rrethanori i vendit dhe i kohës dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Rrethanori i shkakut e i qëllimit dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Rrethanori i mënyrës e i sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe fjalitë e përbëra me nënrenditje.
- Fjalitë me bashkërenditje, llojet e tyre: shtuese, kundërshtuese, veçuese, përmbyllëse.

Sintaksë

Nxënësi:

- përcakton llojin e kallëzuesit (kallëzues i thjeshtë apo kallëzues i përbërë);
- gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e vendit dhe të kohës dhe mënyrat e shprehjes së tyre;
- gjen dhe përdor në fjali rrethanorët e shkakut e të qëllimit dhe mënyrat e shprehjes së tyre;
- gjen dhe përdor në fjali rrethanorët e mënyrës e të sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre;
- argumenton pse një gjymtyrë është rrethanor vendi, kohe, shkak, qëllimi, mënyre, sasi;
- krahason fjalitë e thjeshta me fjalitë e përbëra;
- përcakton nëse fjalia është me nënrenditje ose me bashkërenditje;
- dallon dhe ndërton fjali me bashkërenditje.

Morfologji

Mbiemri:

- Përshtatja e mbiemrit me emrin.
- Shkallët e mbiemrit.

Folja

- Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëftore dhe lidhore, forma joveprore.
- Zgjedhimi i foljeve në mënyrën kushtore, në mënyrën habitore, në mënyrën dëshirore, në mënyrën urdhërore.

Morfologji

Nxënësi:

- dallon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore;
- tregon përshtatjen e emrit me mbiemrin;
- përcakton shkallët e mbiemrit;
- zgjedhon foljet e mënyrës dëftore dhe lidhore në formën joveprore;
- zgjedhon foljet në mënyrën kushtore, mënyrën habitore, mënyrën dëshirore, mënyrën urdhërore;
- dallon dhe lakon përemrat;

<p><i>Përemri</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri vetvetor - Përemri dëftor - Përemri pyetës. - Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor. <p><i>Lidhëzat</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhëzat dhe llojet e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor; - dallon dhe përdor lidhëzat, si dhe llojet e tyre.
<p>Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura. 	<p>Fjalëformim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton mënyrat e fjalëformimit të fjalëve në gjuhën shqipe; - dallon dhe përdor fjalë të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.
<p>Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i pikës, presjes dhe pikëçuditëses në llojet e ndryshme të fjalive. - Drejtshkrimi i zanores ë në trup të fjalës. - Përdorimi i apostrofit te trajtat e shkurtra. 	<p>Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor drejt pikën, presjen dhe pikëçuditësen në llojet e ndryshme të fjalive; - shkruan drejt zanoren ë në trup të fjalës; - përdor drejt apostrofin në trajtat e shkurtra.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E MATEMATIKËS

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Tematika: Numri	
<p>Numrat, fuqitë dhe rrënjët</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numrat e plotë në boshtin numerik. - Shumëfishat, faktorët, shumëfishat e përbashkët, numrat e thjeshtë (të gjitha deri në 100). 	<p>Numrat, fuqitë dhe rrënjët</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh numrat e plotë në boshtin numerik; - identifikon shumëfishat, faktorët, shumëfishat e përbashkët, numrat e thjeshtë (të gjitha deri në 100); - njehson shumëfishin më të vogël të përbashkët të dy numrave në raste të thjeshta.
<p>Vendvlera, krahasimi, renditja dhe rumbullakimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasimi dhe renditja e numrave të plotë (negativë dhe pozitivë). - Rumbullakimi i numrave të plotë në 10, 100 dhe 1000 më të afërt. - Rumbullakimi i numrave dhjetorë në numrin e plotë më të afërt dhe të dhjetën më të afërt. 	<p>Vendvlera, krahasimi, renditja dhe rumbullakimi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krahason dhe rendit numrat e plotë (negativë dhe pozitivë); - rumbullakos numra të plotë në 10, 100 dhe 1000 më të afërt; - rumbullakos numra dhjetorë në numrin e plotë më të afërt dhe të dhjetën më të afërt.
<p>Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjestimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i përqindjes për të përshkruar pjesë të sasive, figurave dhe matjeve. - Përqindja e një sasive (rezultati numër i plotë). 	<p>Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton përqindjen si numri i pjesëve për çdo njëqindëshe;

<ul style="list-style-type: none"> - Shprehja, me thyesë ose përqindje, e një madhësie kundrejt një madhësie tjetër. - Raporti dhe përpjestimi. 	<ul style="list-style-type: none"> - llogarit përqindje të thjeshta të një sasië (rezultati numër i plotë); - shpreh me thyesë ose përqindje një madhësi të vogël kundrejt një madhësie më të madhe; - ndan një madhësi në dy pjesë sipas një raporti të dhënë; - lidh raportin me përpjesëtimin.
<p>Veprimet mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja dhe zbritja e numrave të plotë. - Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë. - Mbledhja dhe zbritja e dy thyesave (raste të thjeshta). - Shumëzimi i një thyese me numër të plotë - Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave dhjetorë me 10, 100 dhe 1000; - Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave dhjetorë me një dhe/ose dy shifra pas presjes me një numër njëshifror. 	<p>Veprimet mbledhja, zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi - mbledh dhe zbret numrat e plotë;</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbledh dhe zbret numrat dhjetorë; - mbledh dhe zbret dy thyesa, raste të thjeshta (psh. $1/8 + 9/8$; $11/12 - 5/6$); - shumëzon një thyesë me numër të plotë; - shumëzon dhe pjesëton numrat dhjetorë me 10, 100 dhe 1000; - shumëzon dhe pjesëton numrat e plotë me 10, 100, 1000; - shumëzon dhe pjesëton numrat dhjetorë me një ose dy shifra pas presjes me një numër njëshifror (psh. $31,7 \times 8$; $4,35 : 5$).
Tematika: Matja	
<p>Gjatësia dhe masa</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë e gjatësisë: kilometri, metri, centimetri, milimetri. - Njësitë e masës: toni, kilogrami dhe grammi. Këmbimi i njësive. 	<p>Gjatësia dhe masa</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - këmben njësitë: kilometri, metri, centimetri, milimetri; toni, kilogrami dhe grammi.
<p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabelat e orareve në kontekste nga 	<p>Koha dhe njësitë e kohës</p> <p>Nxënësi:</p>

jeta reale.	- interpreton tabelat e orareve në kontekste nga jeta reale.
Perimetri, syprina dhe vëllimi	Perimetri, syprina dhe vëllimi
<ul style="list-style-type: none"> - Formula për perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit. - Njësitë litri dhe mililitri për vëllimin e lëngjeve. - Formula për vëllimin e kuboidit me njësi matëse cm^3 dhe m^3. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor formula për të njehsuar perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit; - përdor njësitë litrin dhe mililitrin për vëllimin e lëngjeve; - njehson me formulë, vëllimin e kuboidit me njësi matëse cm^3 dhe m^3.
Tematika: Gjeometria	
Gjeometria në plan	Gjeometria në plan
<ul style="list-style-type: none"> - Vetë të figurave 2D (katrori, drejtkëndëshi, paralelogrami, rombi, trapezi). - Shuma e këndeve në trekëndësh dhe katërkëndësh. - Ndërtimi i trekëndëshit, kur janë dhënë dy brinjë dhe këndi i përfshirë ndërmjet tyre, kur jepen një brinjë dhe dy këndet e anëshkuar kësaj brinje, kur jepen tribrinjët e tij. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - liston vetë të figurave 2D (katrori, drejtkëndëshi, paralelogrami, rombi, trapezi) dhe i përdor për të përshkruar figurat dhe për t'i ndarë ato sipas llojit; - njehson këndet në një trekëndësh; - njehson shumën e këndeve në një katërkëndësh; - ndërton trekëndësha kur janë dhënë dy brinjë dhe këndi i përfshirë ndërmjet tyre, kur jepen një brinjë dhe dy këndet e anëshkuar kësaj brinje si dhe kur jepen tri brinjët e tij.
Gjeometria në hapësirë	Gjeometria në hapësirë
Shndërrimet gjeometrike	Shndërrime gjeometrike
<ul style="list-style-type: none"> - Koordinatat e një pike në secilin kuadrant. - Simetria boshtore. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërton figura simetrike sipas një

<ul style="list-style-type: none"> - Zhvendosja paralele. 	<p>drejtëze;</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen koordinatat e një pike ose vizaton, sipas koordinatave të dhëna, pikën në një sistem koordinativ të gatshëm.
Tematika: Aljebra dhe funksioni	
<p>Shprehjet shkronjore, ekuacionet dhe formulat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shprehje me ndryshore. - Ekuacioni i trajtës $a \cdot x = b$ dhe ekuacione që sillen në këtë trajtë me shndërrime të njëvlershme (a, b numra të plotë). 	<p>Shprehjet shkronjore, ekuacionet dhe formulat</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shumëzon një konstante me një shprehje brenda kllapës [psh. $5(3x + 6y)$]; - thjeshton shprehjet shkronjore duke reduktuar kufizat; - modelon dhe zgjidh ekuacione të trajtës $ax = b$ dhe ekuacione që sillen në këtë trajtë me koeficientë numra të plotë (p.sh., $2x = 8, 3x + 5 = 14, 9 - 2x = 7$).
<p>Vargu, funksioni dhe grafiku</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kufizat e vargut - Funksioni. - Mënyra tabelore dhe diagramë e paraqitjes. - Paraqitja e funksionit me formulë - Grafiku i funksionit. 	<p>Vargu, funksioni dhe grafiku</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjeneron kufiza të një vargu dhe përshkruan rregullin e krijimit të vargut; - gjen kufizën që mungon në një varg të dhënë; - paraqet funksione të thjeshta me fjalë, me formulë, me tabelë, me diagramë; - ndërton grafikun e funksionit $y = ax$.
Tematika: Statistika dhe probabiliteti	
<p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabela dhe diagrama e dendurive. - Mesatarja aritmetike, moda, mesorja. - Diagrami me shtylla. 	<p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor tabelën dhe diagramën e dendurive për të grupuar të dhënat

	<p>diskrete;</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen mesataren aritmetike, modën, mesoren; - paraqet të dhënat nëpërmjet diagramës me shtylla.
<p>Probabiliteti</p> <ul style="list-style-type: none"> - Probabiliteti i ngjarjes së thjeshtë me rezultate të barasmundshme. 	<p>Probabiliteti</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen probabilitetin e ngjarjes së thjeshtë me rezultate baras të mundshme.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar	
<p>Përshkrimi: Nxënësi kupton tekste të shkurtër dhe të thjeshtë të hartuar kryesisht në një gjuhë të përditshme dhe me fjalor të njohur që flasin për jetën e përditshme dhe botën që e rrethon.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Jeta e përditshme, shoqëria, shkolla etj. - Aktorë dhe artistë të famshëm - Bota rreth nesh, kafshët, bimët etj. - Teknologjia - Pushimet dhe veprimtaritë gjatë pushimeve. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste që kanë një fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj; - kupton një mesazh të thjeshtë, si sms, e-mail, etj.; - lexon dhe kupton tekste të thjeshta që flasin për njerëz të famshëm me gjuhë jo shumë të ngarkuar; - identifikon mesazhin kyç në njoftime, faqe interneti etj.; - kupton tekste që flasin për festat dhe pushimet dhe veprimtaritë që njerëzit zhvillojnë gjatë pushimeve.
Përdorimi i drejtë i gjuhës	
<p>Përshkrimi: Nxënësi përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të mësuara gramatikore duke i përdorur ato saktë dhe pa gabime ortografike.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Ndajfoljet e vendit, kohës etj. - Koha e shkruar e thjeshtë dhe e vazhduar - Emrat dhe format e tyre (njëjës, shumës, të numërueshëm, të panumërueshëm) - Sugjerime - Fjalëformimi 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohën e tashme dhe të shkruar; - zgjedhon folje të rregullta dhe të parregullta, në kohën e tashme dhe të shkruar sipas modeleve të dhëna; - përdor emrat dhe format e ndryshme të tyre në mënyrë korrekte;

- bën sugjerime duke përdorur struktura të thjeshta fjalie.

Të shkruarit

Përshkrimi: Nxënësi shkruan tekste të shkurtër përshkrues, kartolina urimi, ditare dhe letra personalembi tema të jetës së përditshme. Nxënësi përdor fjali dhe shprehje të thjeshta të lidhura me lidhëzat “dhe”, “por”, “sepse”.

- Shkrimi i një kartoline.
- Përshkrimi i shtëpisë ku banon.
- Shkrimi i një email-i personal.
- Shkrimi i një ditari ose blog-u personal.
- Përshkrimi shkurtër i vendeve, njerëzve, veprimtarive.

Nxënësi:

- shkruan një kartolinë urimi;
- përshkruan në një letër ose email personal familjen, vendin ku banon, kohën dhe me se merret;
- përshkruan një person, vend ose veprimtari duke përdorur fjali të thjeshta dhe korekte nga ana gramatikore.
- përshkruan itinerarin e një udhëtimi;
- përshkruan thjeshtë njerëzit, vendin, punën, studimet etj.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al